

# Shqipja e folur 40 vjet pas standardizimit të gjuhës

Haki Hysenaj

10 shkurt 2013

## Përmbledhje

Ky punim është një version i shkurtër nga kumtesa me të njëjtin titull që është lexuar në Tiranë me rastin e 100-VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË. Kjo kumtesë, sikundër mund të vihet re edhe nga vetë titulli, prezanton rrugët, ecurit dhe sfidat nëpër të cilat ka kaluar gjuha shqipe e standardizuar, e kodifikuar këtu e 40 vjet më parë në Kongresin e Drejtshkrimit (1972).

## 1 Hyrje

Katërdhjetë vjet pas standardizimit të shqipes çështja e variantit të saj të folur nuk ka qenë ndonjë herë objekt serioz trajtimi në shkrimet për gjuhën standarde. Shkrimet e pakta dhe të shumtën fragmentare për këtë formë ligjërimi, sikur kishin krijuar përfytyrimin se shqipja e folur është një variant standard që është zënë dhe funksion mirë nga të gjithë përdoruesit e bashkësisë folëse shqiptare. Realiteti gjuhësor tregon se gjendja nuk është krejtësisht kështu. E folura e Tiranës, e cila deri vonë konsiderohej si qendër "e shpërndarjes" së një modeli ortoepik për të gjithë shqipfolësit, posaçërisht për situatat formale, sot mund të përshkruhet ndryshe. Evoluimet gjuhësore, si edhe ndikimi i faktorëve jashtëgjuhësorë, sikur ia kanë zbehur Tiranës primatin e të qenit qendër e një modeli ortoepik.

Nga ana tjetër, qendra e dytë, Prishtina, menjëherë pas standardizimit të shqipes, kishte zënë, njëjtë si Tirana, standardin, posaçërisht të shkruar, ndërsa folësit e tij, duke pasur gjuhë native gegërishten, por edhe në pamundësi komunikimi të drejtpërdrejtë me bashkësinë komunikuese, përpiqeshin të imitonin modelin e folur të Tiranës, ose thënë ndryshe e zinin këtë model nga distanca, duke krijuar kështu një kod të përzier me elemente të standardit dhe të gegërishtes letrare.

Prirjet konvergjente për një model të përbashkët ortoepik vazhduan edhe pas krijimit të realiteteve të reja, porse në këtë periudhë, që vazhdon edhe sot, në shqipen e folur të të dy vernakularëve kryesorë, nisi edhe rifunksionalizimi i disa prej tipareve dialektore që më parë kishin mbetur jashtë normës. Edhe në rrethanat e reja gjuha e folur në Kosovë del më pak e stabilizuar dhe me më shumë elemente dialektore. Gjeneza duhet

kërkuar edhe në politikat e planifikimit gjuhësor. (shih: Ismajli, 2003), si dhe në faktin se parimi ortografik nuk kishte përmbushur kërkesat për një model të përbashkët, ose edhe të përafërt.

Hudson, duke folur për gjuhën dhe dialektet thekson se zhvillimi normal i një gjuhe ndodh në mënyrë fare rastësore dhe për më tepër në vetëdijen e folësve, gjuhët standarde janë produkt i një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar nga ana e shoqërisë (Hudson, 2001: 43). Kjo ndërhyrje kishte ndodhur edhe me rastin e standardizimit të shqipes, prandaj shqipja standarde nuk ishte nxënë dhe shtrirë gjeografikisht në nivelin e kënaqshëm.

Me ndryshimin e sistemeve në Shqipëri dhe Kosovë nxënia dhe përhapja e standardit, ndonëse në kushte shumë më të volitshme, për një kohë u pengua edhe nga "fryma kontestuese". Kontestime pati në Shqipëri dhe në Kosovë, njëkohësisht.

## 2 Shqipja e folur sot

Shqipja e folur, 40 vjet pas standardizimit, mund të hulumtohet në shumë rrafshë. Ndryshimet në shoqëri, liberalizimi i gjuhës dhe vënia e kontakteve komunikuese midis pjesëtarëve bashkësisë folëse kanë prodhuar evoluim gjuhësor të shoqëruar me ndryshime të kodeve ekzistuese.

Në radhë të parë ndryshimet më të mëdha duhen kërkuar në modelet që përdoren si variante të të folurit për shqipen standarde. Këtu e kemi fjalën për ortoepinë e shqipes standarde, e cila nuk ishte krejtësisht e njësuar për gjithë bashkësinë komunikuese shqiptare. Rrahman Paçarizi, ndryshe nga Dodi (Dodi, 2004:212), saktëson se shqipja e folur në Kosovë dallonte nga ajo në Shqipëri për faktin se e folura standarde në Shqipëri për bazë kishte marrë "modelin vokal të toskërishtes", ndërsa e folura standarde në Kosovë u mbështet mbi të folurën e vernakularit të Prishtinës, i cili ndonjëherë kishte edhe karakteristika të stërkequra të modelit vokal të Kosovës. "Në Shqipëri mbizotëroi modeli vokal i toskërishtes, i cili nisi të imponohej si të ishte vetë standardi, duke u sjellë me mospërfillje ndaj vetë standardit", shprehet ai (Paçarizi, 2011:97), duke identifikuar kështu një ndër shkaqet e mospërhapjes së kënaqshme të standardit të folur të shqipes së normuar më 1972. Kjo bëri që shqipja e folur të mos përvetësohej në masë të kënaqshme nga folësit e tjerë që kishin gjuhë native ndonjë variant tjetër dialektor, posaçërisht nga folësit e shqipes standarde në Kosovë.

Në Kosovë, ndonëse ishin bërë përpjekje nga njerëz të arsimuar për të imituar modelin e Tiranës, megjithatë varianti i folur nuk ishte njëjtësuar me atë të Shqipërisë. Për gjendjen sot Shkumbin Munishi shprehet se nëse në të kaluarën folësit kosovarë të gjuhës standarde janë përpjekur të modifikojnë shqiptimin dhe ta afrojnë me modelin shqiptimor të Shqipërisë, kohëve të fundit, po këta folës nuk çajnë kokën për një gjë të tillë dhe flasin në gjuhë standarde duke i ruajtur në një masë të madhe elementet tingullore të varianteve dialektore të tyre (Munishi, 2006:92).

Lëvizjet demografike drejt kryeqytetit të Shqipërisë, të cilat me vete kanë bartur edhe modele shqiptimore të karakterit dialektor, kanë ndikuar edhe në lëkundjen e modelit që kishte prestigjin rreth 30 vjet me radhë. Kjo vërehet fare lehtë në të folurën formale

dhe në masmediat e Shqipërisë, në debatet televizive, në të cilat marrin pjesë edhe folës joburimorë të variantit toskë. Krahas elementeve të modelit vokal të toskërishtes në gjuhën e pjesëmarrësve të këtyre debateve përdoren dendur edhe elemente dialektore të të dyja dialekteve të shqipes.

Në këtë situatë, sot mund të flitet edhe për konceptin e quajtur "dialektizim të standardit". Ky konstatim vlen për të dy modelet shqiptimore, për atë të Shqipërisë me qendër Tiranën dhe atë të Kosovës, me qendër Prishtinën.

Dialektizimi i standardit në ligjërimin formal në Shqipëri, në fushë të fonetikës, por edhe në rrafshet e tjera gjuhësore, përpos modeleve të ndryshme shqiptimore që bartin ngjyrimin akustik të gjuhës, sot ngërthen në vete shumë dukuri dialektore të toskërishtes e të gegërishtes. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës dhe tempi i shpejtë i të folurit janë dy elemente të reja të shqipes së folur standarde në Shqipëri. Derisa elementi i parë është me origjinë të pastër dialektore, për të dytin mund të thuhet se është ndikim i italishtes. Elementin e dytë, pa prekur në etimologji, e ka hulumtuar shkencërisht Antonio Belluscio (shih: Belluscio, 2012:433-472), i cili ka dhënë edhe mendimin se sot ka një shpërndarje të thellë midis të shkruarit dhe të folurit e Tiranës (Poaty).

Nga ana tjetër vënia e raporteve direkte midis folësve të së njëjtës bashkësi dhe shkëmbimi i përvojave folëse në afri ka bërë që ky model të absorbojë edhe elemente të gegërishtes. Paskajorja gege dhe format e shkurtra të pjesores, të mbetura jashtë standardit, sot janë gjithnjë e më të pranishme në masmediat të Tiranës. Mjafton të përcillen me vëmendje disa nga debatet e TV Klan-it, Top Channel-it dhe ndonjë emision tjetër televiziv për të argumentuar këtë prirje gjithnjë në rritje. Po në këto televizione, njëjtë si në Kosovë, tashmë janë të pranishme edhe shumë dukuri fonetike të gegërishtes, të cilat kanë të bëjnë me rrafshime opozicionesh midis fonemave. Këto rrafshime janë duke ndryshuar edhe radhët e ndërlidhnive korrelative të fonemave bashkëtingëllore, duke lënë kështu sistemin fonematik të shqipes standarde të zbrazët për disa kundërvënie.

Në shqipen e folur standarde në Kosovë, ishin të njohura proceset e rrafshimit të kundërvënieve midis qiellzoreve q-gj dhe afrikateve ç e xh, vibranteve r/R, si dhe reduktimet e grupeve mb, nd dhe ng. Këto dukuri tashmë takohen edhe në regjistrin formal të folësve të Shqipërisë, gjë që jep për të kuptuar se modeli ortoepik i Tiranës tashmë është duke u begatuar edhe me tipare dialektore, të cilat kishin mbetur jashtë procesit të standardizimit. Këtu hyn edhe përdorimi gjithnjë e më i madh i gjatësisë funksionale të fonemave zanore, tipar qenësor i gegërishtes (Hysenaj, 2011:65-75).

Ky evoluim gjuhësor, që identifikon pranimin e elementeve përjashtuese 40 vjet më parë, mund të emërtohen si prirje për një konvergencë gjuhësore dhe pasurim i standardit të folur. Në këto rrethana tashmë mund të flitet për një standardizim dinamik të shqipes së folur dhe për pasojë edhe për një tejkallim të ngurtësimit që i bën shqipes së folur rregullat drejtshkrimore dhe përzgjedhja dialektore e bazës së standardit.

Çështja shtrohet nëse tashti kemi të bëjmë me varietet të ri të të folurit të standardizuar, i cili del pjesërisht si kopje e standardit të shkruar apo kemi të bëjmë me të ashtuquajturin "interdialekt", të cilin Akmahova e përshkruan si variant i standardizuar i të folurit pa qenë i ndikuar nga standardi i shkruar. Ne konsiderojmë se kemi të bëjmë me variantin e parë, që s'është tjetër veçse evoluim i natyrshëm i gjuhës, që rrjedh nga rrethanat e

reja të krijuara në shoqërinë shqiptare.

Nga përvojat e standardizimit të gjuhëve të tjera, dihet se varianti i folur standardizohet shumë më vonë se i shkruari. Kështu ka ndodhur me anglishten, frëngjishten dhe gjuhë të tjera (shih: Subaçiu).

Prandaj, e përmbyllim këtë variant të shkurtuar të kësaj kumtese me konstatimin se varianti i folur i shqipes standarde është në proces të ndryshimit gradual, me ndikim më të madh të variantit të Tiranës dhe me integrimin gradual të disa elementeve geqe, pranimi i të cilave çon kah formimi i një modeli të përbashkët. Dhe ky model, me variationet shqiptimore dhe elementet dialektore tashmë të rifunksionalizuara do të krijojë komoditet për të gjithë folësit e shqipes standarde.

## REFERENCAT:

- **Ismajli, Rexhep (2003)**. *Standarde dhe identitete*, Dukagjini, Pejë.
- **Munishi, Shkumbin (2006)**. *Disertacion i doktoratës*, Prishtinë.
- **Paçarrizi, Rrahman (2011)**. *Rruga e zhvillimit të shqipes standarde raport me nevojat e komunikimit*, QSA, Tiranë.
- **Haguen (1972)** Cituar sipas Giedrius Subaçiu, Baltu filologjia, Riga.
- **John, Lyons (2011)**. *Hyrje në Gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë.
- **Subaçiu, Diegrius (2001)**. *Vritten and Spoken Standard*, Baltu filologjia, Riga.
- [w.w.w.marxists.org/reference/subject/philosophy/ëorks/.../derrida1.ht](http://w.w.w.marxists.org/reference/subject/philosophy/ëorks/.../derrida1.ht), qasja për herë të fundit më 20 tetor 2012.
- **Dodi, Anastas (2004)**. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- **Hudson. A. Richard (2001)**. *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë.
- **Raka, Fadil (1997)**. *Historia e shqipes letrare*, Blendi, Prishtinë.
- **Belluscio, Giovanni (2012)**. *Si shqiptohet shqipja në gjuhët e Ballkanit*, në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHK, Prishtinë.
- **Hysenaj, Haki (2011)**. *Studimet eksperimentale në fushë të fonetikës dhe norma e folur e shqipes standarde* (Kumtesë e lexuar në Seminari XXXI, e pranuar për botim), Prishtinë.